




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



01-2023

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-256867/22 dt. 24.11.2022, të kërkesve / bashkëpronarëve “Ramiz Sadiku”, sh.p.k., me seli në Prishtinë dhe përfaqësues Avdi Krasniqi nga Prishtina, dhe investitorit “Prime Group” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe përfaqësues Teki Bujupi nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për kompleksin me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm “C4/2”, përkatësisht Ndërtesa “C4-2E”, dhe “C4-2C”, të ndërtuara në kuadër të bllokut urbanistik “C4”, të tërsisë urbane “C”, të Planit Rregullues “Lakrishtë”, në rr. “Ukshin Hoti” dhe “Tirana” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 15.12.2022, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET kërkesve / bashkëpronarëve, “Ramiz Sadiku”, sh.p.k., me seli në Prishtinë dhe përfaqësues Avdi Krasniqi nga Prishtina, dhe investitorit “Prime Group” sh.p.k. me seli në Prishtinë, dhe përfaqësues Teki Bujupi nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-256867/22 dt. 24.11.2022, përdorimi i kompleksit me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm “C4/2”, përkatësisht Ndërtesa “C4-2E” me etazhitet 2B+S+P+10, dhe “C4-2F” me etazhitet 2B+S+P+11, të ndërtuara sipas Vendimit për Lejimin e Ndërtimit, 05 Nr. 351/05-97253/1 dt.15.12.2014, në parcelën kadastrale nr. 10426-0, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914059-10426-0, ZK Prishtinë, konkretisht në kuadër të bllokut urbanistik “C4”, të tërsisë urbane “C”, të Planit Rregullues “Lakrishtë”, në Prishtinë.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugën “Ukshin Hoti” ku kanë dalje hyrjet me numrat: 136/5, 136/4, 136/3, 136/2, 136/1 dhe 136, dhe në rrugën “Tirana” ku kanë dalje hyrjet me numrat: 203, 205, 207, 209, dhe 211, në Prishtinë, dhe të njejtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të tyre në evidencat e regjistrimit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për Mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Kërkesit / bashkëpronarët, “Ramiz Sadiku”, sh.p.k., me seli në Prishtinë dhe përfaqësues Avdi Krasniqi nga Prishtina, dhe investitorit “Prime Group” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe përfaqësues Teki Bujupi nga Prishtina, me kërkesën 05 Nr. 391/02-97253/1 dt.15.12.2014, i janë drejtuar kësaj drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për kompleksin me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm “C4/2”, përkatësisht Ndërtesa “C4-2E” me etazhitet 2B+S+P+10, dhe “C4-2F” me etazhitet 2B+S+P+11, të ndërtuara në kuadër të bllokut urbanistik “C4”, të tërsisë urbane “C” të Planit Rregullues “Lakrishtë”, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10426-0, ZK Prishtinë, të ndërtuara sipas Vendimit për Lejimin e Ndërtimit, 05 Nr. 351/05-97253/1 dt.15.12.2014, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Drejtoria e Urbanizmit, Raportet e Inspeksionit rinal te puneve dhe pershkrimet te dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/1. Inspeksioni i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.a.1. Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.a.2. Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.c. Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.d. Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/3. Inspeksioni i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/4. Inspeksioni i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Avni Ramadani; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Jeton Canhasi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Adnan Bekteshi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikëqyrësi Besim Abrashi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Qani Nuhiu; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga kompanija gjeodeze e licensuar "GeoHorizont" shpk me nr. të licensës 54;

Drejtoria e Urbanizmit, pas pranimit të kësaj kërkesë dhe shqyrtimit të saj, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspeksionit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesat shumëbanesore me afarizëm mund të përdoren, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.


I dorëzohet: Kërkesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-256867/22 DT. 15.12.2022**

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu



U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



Drejtori,
Aber Sadiki

